



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 05.06.2019, ora 17.00

**Drejton mbledhjen -
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

Rendi i Ditës :

- 1. Diskutim mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.*
- 2. Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve që njoftojnë tërheqje nga kandidimi për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- 3. Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit, për disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.*
- 4. Kërkesa dhe ankime administrative të kandidatëve në procedurë verifikimi.*
- 5. Çështje të ndryshme të lidhura me veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ecurinë e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave.*

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Fatjona Memçaj | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "e") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit
2. Enio Haxhimihali përfaqësues i autorizuar i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se anëtarët e Këshillit janë të pranishëm, përveç znj. Arta Marku, e cila, sipas njoftimit, për shkak të një angazhimi zyrtar do ti bashkohet mbledhjes pak me vonesë.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

1. Diskutim mbi Metodologjinë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.

2. Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve që njoftojnë tërheqje nga kandidimi për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit, për disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese.

4. Kërkesa dhe ankime administrative të kandidatëve në procedurë verifikimi.

5. Çështje të ndryshme të lidhura me veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ecurinë e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës diskutimi dhe miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin, Pikëzimin dhe Renditjen e Kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese.

Kryetari i Këshillit orienton të vijohet me diskutimin e pjesës “Meritat Profesionale” në komponentin “Historiku Arsimit” dhe “Kualifikimet Pasuniversitare” duke informuar paraprakisht, së bashku me *Zëvendëskryetaren e Këshillit znj. Vitore Tusha* se, sipas përfundimeve të Këshillit në mbledhjet e mëparshme, është marrë opinion profesional nga Ministria e Arsimit, janë zhvilluar takime me ekspertë të këtij institucioni lidhur me historikun arsimor, titujt akademik, kualifikimet pas universitare, e kështu me rradhë. Shpjegohen çështjet për të cilat vlerësohet se ka vend të konsiderohen dhe të reflektohen në ndryshime, si në variantin origjinal që ka sjellë EURALIUS, ashtu edhe në variantet e ripunuara që janë përgatitur dhe shqyrtuar gjatë mbledhjeve. Materialin e ripunuar pas diskutimeve tona mund tua dërgojmë përsëri për të na dhënë ndonjë mendim tjetër.

Erinda Ballanca i bashkohet mbledhjes së Këshillit gjatë diskutimeve mes anëtarëve të Këshillit (ora 17.18).

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për reflektimin në komponentët “Historiku Arsimit” dhe “Kualifikimet Pasuniversitare” të opinioneve dhe sugjerimeve teknike të ekspertëve të Ministrisë së Arsimit dhe atyre të rezultuara në mbledhjet e mëparshme.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe lidhur me kualifikimet dhe trainimet që mund të konsiderohen për efekt vlerësimi dhe pikëzimi parashtrohet se mund të ketë edhe të tilla që mund ti konsiderojmë tek kurset të ndryshme në të cilat marrim pjesë. Jo vetëm për kualifikimet por edhe për trainimet që i marrin nëpër seminarët këtu, besoj që kandidatët do të na sjellin një listë pa fund. Nëse është në ligj qëllimi për të cilën e është bërë trajnimi, edhe nga ana e anëtarëve në mënyrë të vazhdueshme është thënë që në kuptim të ligjit duhet të ketë përfaqësim nga grupe të ndryshme njohurish të fushave. Duhet të ketë në Gjykatën Kushtetuese ekspert të fushave të ndryshme, përveç çështjeve në fushën e të drejtave të njeriut. Kështu që, vërtetë qëllimi për të cilin është bërë ky specializim afatgjatë mund të mos jetë një gjë e lidhur drejtpërdrejt fushën për të drejtat e njeriut, mund të jetë me taksat por është e rëndësishme. Ndoshta një pjesë e madhe e kandidatëve mund të mos ti kenë të gjitha me vete. Duhet ti kërkojnë dhe mund të

kërkojnë kohë për paraqitjen e tyre sepse ne tani po përcaktojmë metodologjinë e cila do të votohet.

Anëtarët e Këshillit pasi diskutojnë dhe konkludojnë në parim që specializimet nuk kanë lidhje me titujt dhe karrierën akademike. Për konvertimin e rezultateve të arsimimit apo të studimeve mund të përdoren tabelat e njohura ndërkombëtare dhe ato praktika që përdoren nga vetë Ministria e Arsimit. U qartësuan dhe dalluan llojet e titujve akademikë dhe grada shkencore, diferencimi dhe pesha e tyre e mundshme në pikëzim. Po kështu edhe grupimi i specializimeve afatgjata, përfshirë këtu edhe Shkollën e Magjistraturës. Duhet riparë edhe raporti i pikëve maskimale për trainime të tjera kundrejt fitimit të gradës shkencore. Ti jepet më shumë peshë pjesës së parë, pra titujve akademik, gradat shkecore si doktoratura, më pas për specializimet afatgjata dhe sidomos kur janë të fokusuara në çështje për të cilat kandidojnë. Pjesa e trainimeve të tjera të ketë një numër më të vogël pikësh. Materiali i riformular të përcillet tek EURALIUS dhe në Ministrinë e Arsimit ku edhe mund të bisedohet për përmbajtjen dhe saktësinë e termave të përdorura.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit në komponentin “Njohja e gjuhëve të huaja”, për llojet e gjuhëve që pranohet të vlerësohen e pikëzohen, metodikën e pikëzimit etj.

Arta Marku i bashkohet mbledhjes së Këshillit gjatë diskutimeve mes anëtarëve të Këshillit (ora 17.32).

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se Këshilli të mos ia kufizojl vetes mundësinë që të zhvillojë intervistat për të nxjerrë një rezultat përfundimtar për njohjen e gjuhë së huaj. Duke pasur edhe një mendim të ekspertit. Kjo tregon që Këshilli e ka bërë punën në mënyrën të thelluar në lidhje me këtë çështje. Të mos kufizohet pikëzimi duke i caktuar ato vetëm në Metodologji sepse nuk do tia dalim që të krijohet bindja e vërtetë në lidhje me këto pikë. Ata që kanë mbaruar studimet në shkolla jashtë vendit sigurisht që mund të përjashtohen por është për tu diskutuar mundësia edhe për ata që kanë bërë doktoraturën brenda vendit sepse nuk dite gjuhën e huaj, nuk merr dot provimin e doktoraturës. Edhe për gjuhën ata e kanë me nivele zotërimi. Por varet kur e kanë bërë sepse ka plot nga ata që ka mbaruar doktoraturën dhe nuk i dinë në fakt gjuhët e huaja. Në qoftë se Këshilli ka bindjen e plotë që personi ka shkrime në gjuhë të huaja të cilat i ka sjellë nuk ka nevojë të bëni një intervistë. Por në gjykimin tim duke vendosur një rregull përjashtimor ndoshta i kufizoni vetes tuaj mundësinë për të njohur kandidatët dhe për të bërë vlerësimin më të mirë për kandidatët.

Anëtarët e Këshillit pasi diskutojnë dhe konkludojnë në parim që të përdoret Kuadri i Përbashkët European mbi referencat për gjuhët, i cili është i inkluduar në udhëzimin e vitit 2015

të Ministrisë së Arsimit për testimin dhe përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja. Në parim për të gjithë kandidatët që kanë ose jo një dokument për njohjen e gjuhëve të huaja Këshilli do të bëjë intervistë nëse dëshirojnë të testohen për nivelin e njohurive të tyre. Sipas ligjit. Për këtë qëllim Këshilli do të thërrasë ekspertë të gjuhës së huaj. Për elementët model të vlerësimit Këshilli do të mbështetet në mendimin e pedagogëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, përfshirë edhe për mënyrën sesi do të zhvillohet intervista. Kandidatët do të njoftohen për tu shprehur se nëse duan të testohen dhe në cilën gjuhë e preferojnë testimin. Por kandidatët nuk janë të detyruar ti nënshtrohen intervistës për njohuritë e gjuhës së huaj me pasojë mos vlerësimin me pikë për këtë komponent. Niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja do të vlerësohet për 4 gjuhët e përcaktuara nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe vendimi normativ nr. 5/2019” i KED. Këshilli mban parasysht edhe zotërimin e gjuhëve të tjera për të cilat nuk testohet më kushtin që të jetë i shoqëruar me dokument. Përgjithësisht nga testi i gjuhës në intervistë mund të ketë vetëm në raste specifike si p.sh kur arsimimi, grada shkencore janë kryer jashtë shtetit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit në komponentin “Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional”

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se besoj që këtu diskutimi ngrihet më tepër në nivel politikash dhe sigurisht që mund të sjellim argumentet të ndryshme në lidhje me dhënien e pikëve. Megjithatë, jam dakort për sa i takon punës kërkimore. Nga njëra anë ajo mund të jetë edhe një kopjim i materialeve të caktuara. Por puna kërkimore e vërtetë nënkupton që nuk duhet të bësh vetëm kopjim, në të njëjtën kohë duhet të bësh edhe një analizë, duhet të bësh arsyetim dhe të vlerësosh se cilat janë rastet relevante apo jo për praktikën të cilën ti do të zëbërthesh. Sigurisht unë nuk jam kundër caktimit me shumë pikë origjinalitetit dhe impaktit kundrejt afëtsive kërkimore. Ka argumenta për të dyja rastet. Është më e thjeshtë për të bërë një vlerësim nëse një punë kërkimore është cilësore sesa të bësh një vlerësim për një punë kërkimore se sa origjinale është ajo.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe në lidhje me mundësinë e vlerësimit me pikë të volumit dhe sasisë së punës në karrierën e kandidatëve nisur edhe nga vështirësia që lind nga profilet e ndryshme profesionale parashtron se në rastin e avokatëve dhe të studiove avokatore dihet që p.sh. kryetarët e zyrave me shumë llojë të marrin punë në zyrë se sa të përgatisin vetë materialet e punës së tyre. Përveçse nënshkrimit autorësia e tyre në produkt vihet në diskutim nëse është vërtet e tyre apo është prodhim i argatëve të zyrës. Duke kërkuar ndjesë edhe për këtë term të përdorur po kështu a mund ta konsiderojmë produkt një kërkesë padi që ndonjëherë e bën më shumë pala se sa vetë avokati.

Anëtarët e Këshillit pasi diskutojnë dhe konkludojnë në parim që ndërmjet indikatorëve të vlerësimit origjinaliteti dhe impakti, si edhe aftësitë analitike të kenë më shumë pikë se sa aftësitë kërkimore. Ndërsa për raportin e vlerësimit sasior dhe cilësor të jetë 5 pikë me 25 pikë. Vlerësimi sasior është i rëndësishëm kur kanddiatët janë gjyqtarë dhe prokurorë sepse performanca e tyre matet edhe me volumin e punës që kryejnë dhe për këtë. Ka raporte vlerësimi dhe statistika periodike gjyqësore.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe e kalojnë sipas projektit të paraqitur mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit në komponentin “Kualifikimi Shtesë Profesional”

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit në komponentin “Meritat Morale”.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtron se kjo është një nga çështjet dhe nga dilemat më të rëndësishme që besoj secili prej anëtarëve të Këshillit do të trajtojë në verifikimin e meritave morale dhe sigurisht edhe më e diskutueshme për shkak të mungesës së parametrave se kush do jetë informacioni, i çfarë natyre do jetë. Ajo që unë doja ti bëj me dije Këshillit është një rast në të cilin vetë ne si institucion jemi përballur me pikëpyetje shumë të mëdha për të propozuar emra dhe kandidatë të cilët më tej do ti nënshtroheshin vlerësimit të Kuvendit për tu bërë komisioner pranë institucionit të Avokatit të Popullit. E them këtë gjë se mundet që secilit prej nesh ti vijnë mendime. Në dokumentacionin që ne dërguam tek Autoriteti i Dosjeve ishte një kërkesë për të verifikuar nëse personat kanë pasur apo jo probleme të themi kanë qenë bashkëpunëtorë, hyjnë në sferën e zbatimit të ligjit për angazhimin në sigurimin e shtetit apo organet e tjera. Përgjigjja që na erdhi ishte e pastër tërësisht për personat të cilët kishin një moshë të re dhe për një nga personat na erdhi një informacion që kërkonte më shumë kohë për tu thelluar në lidhje me individin. Ata dalin me një vendim dhe vendimmarrja nuk thotë që është bashkëpunëtor sepse aty është e qartë situata për sa i përket ligjit, por thotë ju njoftojmë që ndodhen këto të dhëna në regjistrat tanë se personi ka bërë shkollën e sigurimit për policinë pra nuk ka një të dhënë të qartë dhe mund të jetë i favorizuar sepse sigurisht në dokumentat e veta ai është me ato karakteristikat që të shkojë në shkollën e sigurimit në atë kohë kanë qenë domosdoshmërisht do të bëheshin nga kryetari i degës së brendshme. Pra herë pas here nuk ka konkluzion. Kur nuk ka një konkluzion përfundimtar sigurisht që nuk është një kriter përjashtues përse i përket plotësimit të kriterëve formale për ta kaluar. Por a është një kriter për ta renditur më poshtë në listën që duhet dërguar? Në rastin konkret kjo ishte problematika që ne patëm. Pra sfida jonë brenda për brenda grupit të komisionit tonë të vlerësimit ishte që favorizimi të themi nuk përbën kriter skualifikues, unë e kualifikoj prapë se

prapë por a mund ta rendis po aq lart kur bëhet fjalë për Gjykatën Kushtetuese që është garancia e të drejtave të njeriut apo në rastin tonë që jemi institucion që mbron të drejtat e njeriut?

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe për këtë çështje parashtrohet se në vijim të asaj që thotë Avokatja e Popullit edhe unë pa dashur po “zbuloj” ndonjë sekret. Edhe ne si institucion jemi ndeshur me praktika të ngritjes në detyrë. Për shkak të materialeve të referuara nga Shërbimi Informativ është bërë e pamundur ngritja në detyrë e një kuadri të caktuar. Informacioni që referohej ishte i një natyre shumë të vakët si p.sh ka të dhëna se ka një biznes të një natyre të caktuar. Fakti është që më pas ajo e dhënë u sqarua, sërish nga Shërbimi dhe rezultoi e pavërtetë. Për 2 vjet ai njeri u pengua nga kandidimi, rritja në detyrë dhe pati një efekt negativ. Kështu që duhet kujdes. Për kriteret morale dhe integritetin është ndryshe të thuash ka të dhëna dhe ndryshe të thuash që është provuar.

Anëtarët e Këshillit pasi diskutojnë dhe e kalojnë me disa shtesa dhe ndryshime pjesën Meritat Morale duke evidentuar nevojën që të kërkohen dhe të vlerësohen me kujdes informacionet nga institucionet ligjzbatuese dhe informacione të mundshme apo akte vlerësuese nga të gjitha institucionet e duhura sipas profilit profesional të kandidatëve lidhur me vlerësimin etik e profesional, masat disiplinore, si edhe për sjelljen e tyre gjatë dhe jashtë ushtrimit të profesionit për të verifikuar e vlerësuar nëse ka gjetje që e çënojnë figurën etike dhe morale të kandidatit sipas parimeve të parashikuara në ligje, parimeve të Bangalores etj.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë për mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit në komponentin “Meritat Organizative, drejtuese dhe menaxheriale”.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtrohet se do të doja të bëja një ndërhyrje të paktën për atë kategori ku vendimmarrja nuk është një proces shumë i dukshëm thelbësor. Jam dakort me faktin që llojet e vendimeve ndryshojnë nga njëri tek tjetri por nuk jam e dakort me mendimin që një avokat merr më pak vendime në ushtrimin e profesionit të tij se sa një gjyqtar. Sipas një rregulli edhe avokatit i duhet të drejtojë zyrën e vet ose të drejtojë pozicionin që ai ka. Prandaj çdo ditë i takon që të marrë një vendim menaxherial drejtues, madje ai është më i ekspozuar ndaj vendimmarrjeve menaxheriale sesa një gjyqtar në karrierë. Atij do ti duhet të marrë vendime p.sh. për specialitetet që do të mbulojë, nëse duhet të punësojë ose jo një person të caktuar, nëse duhet ta promovojë atë apo jo. Avokati merr vendime të aspektit ligjor juridik, p.sh. për mënyrën se si e këshillon një individ të caktuar apo palët për të gjetur një marrëveshje midis tyre. Gjithashtu fuqia e tij vendimarrëse tregohet edhe me kapacitetin e aftësisë për të marrë vendime p.sh. për mënyrën se si të përfundoj çështjet me sukses. Shpejtësia e përfundimit dhe rezultati i çështjeve mund të jenë tregues të kapacitetit të tij vendimarrës. Edhe një zyrtar publik, qoftë ky me një pozicion drejtuesi, patjetër që edhe ai ka vendimmarrjet

e veta për mënyrën se si e delegon detyrat, cilave detyra duhet ti japë prioritet, në cilat afate etj. Pra për ta përmbyllur vështirë mendoj se mund të ketë një lloj profesioni i cili nuk mund të arrijë që të demostrojë aftësitë e tij vendimmarrëse.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe e kalojnë sipas projektit të paraqitur mënyrën e vlerësimit dhe të pikëzimit në komponentin “Meritat Organizative, drejtuese dhe menaxheriale”, duke mbajtur parasysh nevojën për të kërkuar informacione dhe statistika të mundshme që lidhen me dëshminë e këtyre aftësive, sigurinë që kandidatët të njoftohen dhe paraqesin me shkrim programin dhe vizionin e tyre për kandidimin, si edhe vlerësimin e informacioneve duke pasur parasysh natyrën e profileve profesionale të ushtruar nga kandidatët.

Këshilli vijon mbledhjen me pikën e pestë të rendit të ditës “Çështje të ndryshme të lidhura me veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe ecurinë e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave.”

Kryetari i Këshillit shpjegon se Avokati i Popullit dhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës parashtruan dy propozime për të diskutuar të cilat lidhen edhe me vendimmarrjen për lejimin dhe ndalimin e kandidimeve, Avokati i Popullit për transparencën dhe mënyrën e vendimmarrjes së KED dhe përfaqësuesi i Presidentit lidhur me nevojën për të reflektuar edhe një herë nëse duhet marrë një vendim në këtë fazë për kandidatët magjistratë apo duhet pritur ezaurimi i plotë i procedurës së rivlerësimit kalimtar. Meqenëse në mbledhje janë të shtatë anëtarët e Këshillit është momenti për ti trajtuar.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe parashtron se është një çështje e cila është trajtuar shumë nga Këshilli në këndvështrime të ndryshme. Çështja që unë dua edhe njëherë vëmendjen e Këshillit dhe sigurisht edhe të Euralius sepse qëndrimi i Euralius-it ka qenë një qëndrim i caktuar të paktën një nga dy mbledhjet. Nuk keni qënë ju znj. Agnes, ka qenë një njeri tjetër që unë akoma sot e kësaj dite nuk kam arritur ta di emrin kush ka qenë përfaqësues i Euralius-it në atë mbledhje sepse edhe unë personalisht nuk kam qënë. Ka pasur të bëjë me rregulloren e miratuar për kriteret e vlerësimit, jo me atë të verifikimit. Ju nuk keni qënë, s’kam qënë as unë e pranishme, por qëndrimi i atij eksperti ka qenë në gjykimin tim tej detyrave të një eksperti dhe prandaj unë dua që ti paraqes edhe njëherë argumentat në lidhje me mënyrën se si secili prej nesh lexon ligjin në rastin konkret.

Ne kemi bërë një parashtrim në lidhje me faktin se cili ka qenë përcaktimi kushtetues dhe çfarë ka përcaktuar Kushtetuta në lidhje me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe me rolin e Avokatit të Popullit. Dhe paragrafi 149/d pika 3 thotë Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pra nuk ka asnjë kufizim për pjesëmarrje në mbledhjet dhe veprimtarinë

e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Duke shtuar dhe veprimtarinë e rrit funksionin që Avokati i Popullit ka në këtë si proces dhe konsiderohet një proces i veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që çon më tej në rankimin e anëtarëve të kandidatëve për anëtar në Gjykatën Kushtetuese. Pse ka lindur, pse është shtuar dhe perimetri, është bërë edhe debati në lidhje me faktin se si ka qenë historiku. Historiku ka pasur fillimisht mbledhje të hapura, pastaj mbledhjet janë bërë të mbyllura. Pasi mbledhjet janë bërë të mbyllura në komentarin që i është bërë Kushtetutës ka një historik të caktuar, duke trajtuar pikërisht faktin se për çfarë arsye është thënë të ketë edhe në mbledhje dhe në veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi prezencën e Avokatit të Popullit. Është përzgjedhur Avokati i Popullit, mund të ishte edhe dikush tjetër, si garantues i një syri tjetër për të mos patur mbledhje tërësisht të mbyllura dhe jashtë vëzhgimit të themi të një personi të tretë, që mund të jetë publiku. Sigurisht nuk kishte nevojë që të ishte një person politik por të ishte një institucion që në rastin konkret është institucion kushtetues dhe është Avokati i Popullit. Më tej, detyrat të cilat ka Avokati i Popullit janë të përcaktuara në ligj dhe duhet të merren që të gjitha në përputhje dhe nën vëzhgimin ose nën trajtimin që i ka bërë për këtë Kushtetuta.

Nuk dua të ndalem në kompetencat që Avokati i Popullit ka në kuadër të hedhjes së shortit por dhe ato janë kompetenca shumë të rëndësishme sepse bën një raport monitorimi pikërisht për mënyrën e hedhjes së shortit dhe procedurën e ndjekur. Edhe aty nuk është një kompetencë të cilës nuk i duhet dhënë kuptim. Është një kompetencë që unë e gjykoj shumë e rëndësishme pikërisht sepse faktorët e tjerë nuk kanë zë për të folur. Aq më tepër në rastin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kur nuk ka vullnet nga gjyqtarët apo prokurorët të secilës fashë për të kandiduar e për të paraqitur kërkesë pranë KLGJ-së ose KLP-së për tu përfshirë në listën e personave për tu përfshirë në short. Tani në këtë Këshill të përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi ku nuk ka asnjë mundësi për tu ankimuar nga kandidatët ka qenë besoj roli jonë edhe më i rëndësishëm në lidhje me përgatitjen e raporteve, rol të cilin jemi munduar ta ushtrojmë me përgjegjshmëri, pavaresisht rezultateve konkrete të ndryshimit të vendimmarrjeve për funksionimin në kushte ekstraligjore të KED-së, sipas qëndrimeve të caktuara.

Të vijmë në rolin apo në funksionin aktual. Për sa i përket pjesës së dytë të parashikimeve kushtetuese, risillet përsëri në ligj roli i Avokatit të Popullit dhe ky rol jo më kot vihet në nenin 233 që është transparenca. Menjëherë pasi përcaktohet se mbledhjet e KED janë të mbyllura parashikohet me ligj pjesëmarrja e Avokatit të Popullit në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. Nuk ka asnjë parashikim tjetër i cili ta kufizojë në ndonjë mënyrë pjesëmarrjen tone, as procedural as ligjor. Dhe në këtë kuptim rregulloret të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen tonë në ndonjë pjesë të veprimtarisë apo të mbledhjeve janë tërësisht jashtë

parashikimit ligjor. Asnjë akt i nxjerrë nga ky Këshill nuk mund të jetë në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës dhe ato të ligjit. Në këtë kuptim nuk arrij ta gjes se si mundet një ekspert të mendojë që ligji mund të parashikojë diçka por rregullorja mund të parashikojë një gjë tjetër duke kufizuar të drejtat e parashikuara në ligj. Është tjetër gjë nëse eksperti mendon a duhet të ndryshohet ligji e do të ishte më mirë të mos ishte parashikuar në ligj. Kjo është një gjë tjetër. Mund të ketë qenë edhe vullneti i Euralius kur janë bërë ligjet, por është një vullnet të cilin ndoshta Komisioni i Venecias apo parlamenti shqiptar nuk e ka mbështetur.

Me flagrante është situata po ta lexosh në anglisht nenin 233 (*lexon përkthimin në anglisht*). Ajo që është thënë në anglisht për mbledhjen e mbyllur, “dhoma e këshillimit” është e thënë për të gjithë kohën e zhvillimit të mbledhjes dhe menjëherë pas kësaj fjale thuhet që merr pjesë Avokati i Popullit në mbledhjet dhe veprimtaritë. Pra aq më shumë në anglisht nuk ka vend për tu ngatërruar koncepti i dhomës së këshillimit me mbledhjet e mbyllura ose për të pas një lloj difference midis këtyre të dyjave. Kështu që në këtë këndvështrim unë mendoj që çdo lloj vendimmarrje e Këshillit, duke iu referuar zoti Dvorani, unë kam kohë që i kam kërkuar transkriptet e atyre mbledhjeve, zoti Dvorani ka thënë në mbledhje që kemi bërë gabim, na kanë këshilluar që kemi bërë gabim na dëgjuaat që dje në mbledhje është thënë që është bërë gabim dhe ne duhet të reflektojmë. Unë e kam kërkuar këtë transkript dhe ende nuk e kam. Në këto kushte mua më lind ideja të mendoj se vendimmarrja e parë e Këshillit është konsideruar e gabuar nga dikush, se nga kush ta kuptojmë. I vetmi person që ka ndryshuar qëndrimin kanë qenë këshilltarët dhe Euralius eventualisht. Në mbledhjen e parë nuk kanë pasur komente në lidhje me vendimmarrjen e Këshillit. Nuk kanë pasur një draft në fakt ku Avokati i Popullit të ketë qenë jashtë por duket që ndoshta anëtarët dinë diçka më shumë sesa dimë ne. Unë jam kujdesur gjithsesi që specifikisht të pyes nëse ka pasur ndonjë koment në lidhje me faktin nëse qëndrimet tona në Këshill, në rolin e vëzhguesit sipas bindjes së ekspertëve apo të anëtarit pa të drejtë vote sipas bindjes time, kanë qenë jo parimore apo jo. Pra të pyes nëse ky qëndrim ka ardhur për shkak të faktit se nuk kemi pasur qëndrime parimore por kemi pasur qëndrime të ndonjë natyre tjetër dhe kam pasur garancinë e plotë se në asnjë rast, në asnjë mbledhje dhe në asnjë takim nuk është bërë referencë për Avokatin e Popullit, nga asnjë person dhe nga asnjë individ dhe se të vetmet komente apo të themi vullnet pozitiv apo qëndrim, ndarje qëndrimi mendimi me Këshillin, nëse ka pasur, ka pasur të bëjë me mundësinë ose pamundësinë e ndikimit politik tek anëtarët e Këshillit apo në mbledhjet e Këshillit. Kjo sepse jashtë mbledhjeve të Këshillit qëndrimi apo vullneti i karakterit politik nuk di nëse është i mundur apo i pamundur për tu realizuar por të paktën flitet për brenda mbledhjes së Këshillit.

Kështu që unë gjykoj që Këshilli duhet ta marrë edhe një herë në konsideratë vendimmarrjen duke qenë se praktikisht është një rregullore e cila parashikon gjë tjetër dhe ka 2 rregullore që parashikojnë një gjë tjetër. Unë nuk mendoj se konfliktet në Këshill për çfarëdo lloj arsye ndihmojnë reformën në drejtësi. Për këtë arsye kam menduar se duke pritur një kohë relativisht të gjatë, duke u munduar që të tregojmë rolin tonë, vullnetin tonë, vëmendjen tonë e ta adresojmë duke u përpjekur dhe vetë të kuptoj nëse ka ndonjë shqetësim konkret për ndonjë qëndrim joparimor nga ana e institucionit tonë. Mendoj se është më e ndershme nga ana ime që t'ja shpreh Këshillit këtë duke kërkuar që të marrë në konsideratë edhe njëherë këtë të drejtë të ligjshme të mohuar të Avokatit të Popullit. Pra të mos marrë pjesë në një pjesë të caktuar të veprimtarisë që është një e drejtë e mohuar po një e drejtë e ligjshme e jona, kushtetuese dhe e ligjshme, që e konsideroj shumë të rëndësishme se na e ka përcaktuar ligjvënësi. E konsideroj të padrejtë dhe të paduhur krijimin e konflikteve të çfarëdolloji të cilat mundet të ndikonin sado pak besimin që mund të kishte publiku në këtë pjesë të reformës në drejtësi apo ndoshta edhe më gjerë. Për këtë arsye unë kam menduar që nuk do të ushtroja të themi ato që parashikimet apo mundësitë që ligji më njeh, qoftë mundësia e paraqitjes së padisë kundër atij vendimi në Gjykatën e Apelit Administrativ apo mosmarrja pjesë në mbledhjet e Këshillit për shkak të kësaj në gjykimin tim paligjshmërie. Por nga ana tjetër në kuadër të atyre kompetencave që të gjithëve na njeh ligji, juve sigurisht në masën e përcaktuar si anëtarë të Këshillit dhe mua si vëzhguese në rastin më të keq, mendoj se duhet që ta trajtojmë këtë çështje në mënyrë ligjore dhe për të mirën e punës.

Ndërkohë që për sa i përket çështjes së transparencës, unë përsëri mendoj se fakti që unë kam kërkuar transkriptet për disa muaj, pra transkriptet edhe vidiot, edhe më fal audiot e mbledhjeve për të diskutuar disa problematika e pikërisht këto çështje të cilat unë po i trajtoj tani dhe çështja nuk është vënë as në rendin e ditës në mënyrë të vijueshme mendoj se e cenojnë nivelin dhe standardin e transparencës në Këshill. Këto kompetenca përveç të tjerave që janë përcaktuar në nenin 233, janë edhe kompetenca që ne i kemi nga Kushtetuta për shkak të funksionit dhe të misionit tonë, tek transparenca për sa i përket marrjes së dokumentave dhe informacioneve ne kemi parashikim të qartë kushtetues për rolin dhe funksionin që ne kemi, për të cilin neni 63 pika 4 thotë që *organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar ti paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij pa asnjë lloj kufizimi*. Kjo përtej rolit që ne kemi në mënyrë specifike këtu, por edhe sikur të mos e kishim këtë kompetencë dhe mos e kishim këtë parashikimin këtu. Kështu që unë do ti kërkoja realisht Këshillit që ta rikonsideronte edhe një herë vendimmarrjen e tij në lidhje me këtë çështje dhe të tregonin një rol tjetër, një qasje tjetër ndaj çështjes së transparencës.

Unë ende nuk arrij dot të kuptoj dhe të gjej cili ka qenë eksperti i Euralius-it i cili ka thënë që ne kemi marrë vendimin në lidhje me Avokatit e Popullit dhe kjo çështje është e mbyllur. Unë nuk e di çfarë vendimi mund të marrë eksperti i Euralius-it në vendimmarrjen e Këshillit. Kjo më duket p.sh. e pamundur. Nuk ekziston mundësia që të mos dijë dhe të mos arrijë dot të kuptojë se cili ka qenë ky ekspert sepse nuk kam mundësi të kem procesverbalet e mbledhjes dhe të verifikoj nëse kjo është e vërtetë apo jo, nëse përfaqësuesi që unë kam patur në këtë mbledhje ka thënë të vërtetën apo jo. Sepse ato që unë kam qenë vetë në mbledhje dhe e di që ka pasur në rastin më të mirë për të thënë një tollovi në lidhje me vendimmarrjen e parë që paska qenë gabuar dhe që duhet të ndryshonte këtë unë e kam dëgjuar me veshët e mi.

Këto ishin ato që kisha dhe do të doja vërtet që, për sa të jetë mundur, të mundohemi tia kthejmë institucioneve dhe Avokatit të Popullit, jo Erinda Ballancës se kjo do mbetet gjatë gjithë kohërave, ndoshta unë s'dua të vijë fare në KED se mund ta kem një hall më shumë. Ndryshe nga puna e të gjithë juve këtu për mua vazhdon të mbetet një punë e papaguar, por nuk më shqetëson kjo, nuk ka asnjë problem për këtë. Por nuk mund ta pranoj që nesër të thonë ke pasur një pozicion, ke pasur një rol dhe e ke pranuar që në kundërshtim me ligjin të mohohet e drejta e institucionit të Avokatit të Popullit. Faleminderit. Dhe një gjë. Unë nuk jam e mërzitur po gjithmonë e bëj, kush më ka dëgjuar në mbrojtje, e kam fjalën që jam pak pasionante në trajtimin e çështjeve.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me diskutimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehin qëndrimin lidhur me çështjet që parashtroj Avokati i Popullit të cilët u shprehën se është e papërshtatshme e të pavend që në këtë mbledhje ti bëhet “gjuqi” Euralius-it dhe anëtarëve të KED se si vendosin dhe përse e vendosin. Anëtarët e Këshillit kanë debatuar gjatë këto çështje pavarësisht nga qëndrimet e Euralius dhe secili prej tyre ka mbajtur qëndrimin përkatës, përfshirë edhe mënyrën se si kuptohet parashikimi kushtetues për pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit si vëzhgues në procesin e shortit, në mbledhjet dhe në veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Tashmë KED është në kulmin e procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave ndaj edhe nuk mund të lejohet

ndryshimi i rregullave në këtë proces. Nëse duhet të jenë mbledhjet e hapura apo të mbyllura etj. përfshirë çështjet që parashtrori Avokati i Popullit, këto janë çështje që duhet ti adresohen Kuvendit për të verifikuar nëse ligji ka mungesa apo kontradikta. Për këtë çështje anëtarët e Këshillit kanë debatuar shumë gjatë derisa kanë marrë vendimet përkatëse, duke dhënë arsytet përkatëse pro apo kundër. Nga koha e vendimmarrjeve nuk kanë ndryshuar rrethanat dhe nuk ka ndonjë rregullim të ri nga ligjvënësi që të sjellë ndryshimin e rregullave të KED. Ai proces i gjatë diskutimesh dhe miratimi i akteve u realizuar pikërisht me qëllimin që, në momentin kur të fillonte zyrtarisht procedura e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave, rregullat të ishin të përfunduara, duke shënuar se procesi fillon me miratimin aktit të fundit.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe për këtë çështje parashtron se meqenëse nuk është marrë ende një vendim për këtë, për t'ia kujtuar dhe Këshillit, të paktën nga unë si përfaqësuesi i institucionit të Presidentit të Republikës ndryshimi i rregullave në të dy vendimet nr.4 dhe 5, pikat 41-45, e mbaj mend shumë mirë edhe debatin këtu, është e vërtetë nuk jemi për të bërë asnjë gjyq. Por një gjë e mbaj mend mirë. Kundërshtimin që ka bërë eksperti i misionit Euralius. Erinda nuk ka qenë, kam qenë unë. Nuk ka thënë mendim ekspertizë, por ka thënë ne jemi kundër pjesëmarrjes të Avokati i Popullit në diskutimin e çështjeve në vendimmarrje. Do të vijë radha që edhe procesverbalet e asaj mbledhje do të zbardhen dhe do të evidentohen. Një nga shkaqet procedurale që ka ndryshuar në vlerësimin tim e që kam mbajtur fjalën në ato momente, ishte mospjesëmarrja në këtë vendimmarrje e një prej anëtarëve të këshillit, znj Fatjona Memçaj, e cila, për arsye të deklaruara nuk merrte pjesë në hartimin atyre rregullave për shkak të konfliktit të deklaruar të interesit. Dallimi midis dy akteve, vendimit nr. 1 për organizimin dhe funksionimin e Këshillit, dhe vendimeve nr.4 dhe 5 që flasin për verifikimin, rankimin dhe pikëzimin e që solli ndryshim në rregullin për pjesëmarrjen, solli edhe ndryshimin kuorumit të kësaj vendimmarrje. Këto dy të fundit u miratuan me një barazi votash 3-3 dhe duke iu referuar si zgjidhje, si bazë ligjore, ligjit për organet kolegjiale, ku vendos vota e kryetarit, këtu ka pasur kontekst edhe nga Avokati i Popullit përfaqësuesi i saj, me sa kujtoj unë. Unë kam kërkuar në atë moment që kjo çështje të rivihet në diskutim në tryezën e Këshillit pasi kjo gjendje të kalojë. Pra rregullat sipas këtyre dy vendimeve të përfundojnë dhe të ridiskutohen dhe të marrë pjesë edhe zonja Memçaj që ka pas konflikt interesi, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit në qoftë se do të duhet të unifikohet një qëndrim për të gjithë vendimet, edhe për vendimet nr. 4 dhe 5, duke thyer rregullat, duke ndryshuar dhe përmirësuar rregullat në unison. Ne e kemi mbështetur këtë kërkim të Avokatit të Popullit dhe e vlerësojmë që pjesëmarrja e tij gjatë gjithë veprimtarisë do të thotë edhe gjatë procesit të diskutimit. Vendimmarrja është e Këshillit. Ndryshim të situatave ligjore nuk ka. Qenia në procedurë e sipër nuk ndikon a duhet të

përfshihet Avokati i Popullit. Në këtë tryezë është thënë që rregullat edhe ndryshojnë, është thënë dhe nga anëtarët e Këshillit, nuk është çudi që të ndryshojnë. A ndikon pjesëmarrja e Avokatit të Popullit në ato procedime që kanë kaluar për shkak të dorëheqjes? Jo. Në tryezën këshillit është vetëvendosur. Në përmirësim të një situatë mund të veprojë dhe mund të ndikojë, por në përkeqësim kurrsesi. Unë mendoj që është vendi që Këshilli ta marrë në diskutim mund të vendosë mos ndryshimin rregullit. Por që diskutimi duhet të merret. Është kërkuar disa herë, ka mbi dy muaj. Ne e vlerësojmë të qenësishme pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit pikërisht tani që do të fillojë procesi me delikat që është pikëzimi.

Ardian Dvorani e merr fjalën dhe shprehet se është një gjë e pandodhur, e padëgjuar ndonjëherë që një organ kolegjal, nga parlamenti e çdo organ tjetër, të rivërë në diskutim një vendimmarrje sepse ka munguar dikush. Në qoftë se ka pasur një kuorum, nëse është marrë një vendim dhe ai ka qenë i ligjshëm sipas procedurës, nuk mund të jetë motiv mungesa e x numri deputetesh në atë diskutim që po të vinin edhe ata do të ndryshonte mazhoranca. Unë kështu e kuptoj edhe qëndrimet se ne nuk kemi asnjë arsye të rivendosim për këtë motiv.

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se cila ishte arsyeja nga hera e parë në të dytën z. Dvorani se edhe atëherë ska pasur asnjë ndryshim ligjor nga rregullorja e parë në rregulloren e dytë. Po thoni tani nuk ka ndryshuar ligji dhe nuk mund ta rishikojmë vendimin tonë. Ju mund të vendosni çfarë të doni kjo nuk diskutohet.

Ardian Dvorani vijon duke u shprehur se kemi marrë vendime dhe ky është një organ kolegjal kushtetues, si gjithë të tjerët, i cili po merr vendime dhe nuk merr duke bërë llogari se kush mungon dhe kush nuk vjen. Merret vendimi me atë kuorum që ka qenë. Është në përputhje me ligjin dhe me procedurën e vendimmarrjes? Mbaroi. Tani fakti se vjen një anëtar që mungonte apo i ndryshon dikujt mendja nesër, kjo është një çështje tjetër. Por kjo nuk mund të jetë motiv meqenëse mungon një anëtar, tani ne të ridiskutojmë edhe njëherë sepse kjo nuk është normale. Edhe unë mund të rikonsideroj veten, por nuk është normale. Kjo nuk ndodh në asnjë lloj organi kolegjal. Nuk është normale. Ndaj nuk kam ndërmend tu jap më ndonjë përgjigje.

Bledar Dervishaj vijon fjalën dhe parashtro se unë nuk e kam pranuar atë vendimmarrje, nuk kam lënë shteg për keqinterpretime. Ne nuk kemi një rregull që KED-ja këtë vendim e merr me shumicë të thjeshtë apo të cilësuar. E kemi të qartë si merren vendimet. Por përderisa rregulli i përgjithshëm i vendosur në vendimin nr. 1 u thye ose u ndryshua me një shumicë më të ulët, ka qenë një argumentet shtesë që kam ngritur në Këshill që të vendoset për këtë problem nga të 7 anëtarët. Unë nuk është se po e mbështes argumentet vetëm këtu, pikërisht sepse Avokati i Popullit në pjesën kur diskutohet vendimmarrja duhet të ishte aq më

shumë prezent, pasi ajo e tha edhe pak më përpara. Dërgimi i çështjes në Gjykatën Administrative për të kundërshtuar këto dy pika të rregulloreve, nuk do të ishte një imazh i mirë mbi ecurinë e procesit, mendoj unë, apo braktisja me mospjesëmarrje në seancat e Këshillit pikërisht se iu mohua një e drejtë.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se diskutimi ka qenë pikërisht pyetja që kam bërë unë Z. Dvorani. Çfarë ka ndryshuar nga rregullorja e parë, që ne miratuam në rregullat e përgjithshme dhe ju keni thënë në mënyrë të shprehur reflektojmë dhe dëgjojmë çfarë na thonë. Këtë dua të na sqaroni. E kam shumë të qartë se mund të gjendet çfarëdolloj mekanizmi por po i bëhet referencë një gjëje që nuk është ligji. Qartësisht në atë mbledhje nuk i bëtë referencë diçkaje që është ligji, sepse po të thonit ka një ndryshim ligjore, ka një interpretim ligjor, një unifikim të një praktike, nuk ka asnjë problem, të gjithë e mirëpresim apo keqpresim, nuk ka asnjë rendësi. Ju thoni duhet të ndryshojnë kushtet ligjore për të marrë një vendimmarrje tjetër, ndërkohe që kur unë jua thash këtë gjë herën e parë nuk ishit me këtë mendim, e keni ndryshuar, pra ska nevojë për ndryshim në ligj thoni, ky është e qëndrimi që ne mendojmë. Unë dua të sqaroj një gjë tjetër. Në qoftë se secili prej nesh jep një argument në mbrojtje të pozicionit të vet apo pozicionit që ligji i njeh institucionit, unë në fakt nuk i kam bërë gjyqe asnjë njeriu dhe s'kam ndërmend ti bëj gjyqin askujt dhe skam qëne as gjyqtare në jetën time as një ditë të vetme, për arsye nga më të ndryshmet. Kështu që për këtë, secili jep mendimin dhe opinionin vet por gjyq nuk i bën asnjë njeriu. Dhe nuk shoh fare me vënd faktin që të mendoni se unë kërcënoj Këshillin. Edhe kjo është e tepërt dhe nuk e pranoj sepse jam duke e trajtuar problemin, në gjykimin tim, në mënyrë shumë paqësore, duke u munduar që të tregoj një orientim, pozicionin tim, vendin tim, ti jap mundësi Këshillit ta shikoj se si do jetë, si është ndërhyrja dhe si është vendimmarrja. Por nuk ka asnjë vend, as një lloj mundësie, të thuhet se unë kam ndërmend të kërcënoj juve apo ndonjë tjetër asnjë lloj organi pasi nuk e kam as për natyrë as për sjellje absolutisht fare në asnjë rast. Për sa i përket diskutimit që ne kemi filluar dhe nuk mund të ndryshojnë rregullat, rregullat nuk kanë të bëjnë as me verifikimin e individit, por me prezencën e një lloj kontrolli më të madh që ndoshta mund të ekzistojë në lidhje me vendimmarrjen dhe nuk i preket asnjë të drejtë por garantohet një të drejtë më shumë, nuk i cenohet askujt një drejtë. Por nëse një gjë e tillë sigurisht do vazhdojë në vendimmarrje, në vendime do të duket fakti që mbledhja nuk është më me prezencën time sepse këtu në këto vendimet tuaja nuk duket që jam prezent vendimmarrje. Njerëzit nuk e dinë, që të jemi të qartë. Në vendime nuk rezulton që kemi diskutuar ne në Këshill, ju si Këshill dhe unë si vëzhguese. Normal edhe kandidatët sepse mbledhjet janë të mbyllura. Pra nuk duket që të këtë një nuancë

të hollë që në një pjesë të vendimmarrjes Avokati i Popullit nuk ka qenë. Gjithkund në vendim lihet përshtypja se Avokati i Popullit ka qenë prezent gjatë gjithë kohës.

Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se në përdorim një formulë klasike si çdo akt administrativ. Po kështu edhe në procedurën gjyqësore. Si mund të shkruash p.sh. me pjesëmarrjen në pjesë e parë, por nuk mori pjesë në pjesën e dytë. Këto rregulla janë të shkruara dhe të botuara në Fletoren Zyrtare dhe i dinë të gjithë, prezumohet se i dinë të gjithë. Do të bëjmë ndonjë novitetet edhe me mënyrën se si shkruhen aktet?

Erinda Ballanca vijon diskutimin dhe shprehet se aktin mund ta shkruani si të doni. Unë kam qëndrimin tim sa i përket akteve. Dhashë një argument që nuk e ka asnjë njeri, nuk e shikon këtë detaj apo, sepse këtë gjë shikojnë vetëm njerëzit që janë këtu brenda. Ndërsa persa i përket kërkesës tjetër që i kam bërë Këshillit për të pasur regjistrimet audio të Këshillit, kjo është një gjë që as nuk e keni futur në rendin e ditës dhe as nuk mi keni dhënë për ti dëgjuar ndonjëherë.

Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se për ti dëgjuar mund ti dëgjoni, por nuk mund ti merrni më vete. Askush nuk mund ti marrë jashtë zyrës së KED.

Erinda Ballanca vijon diskutimin dhe shprehet se nuk asnjë rregull që nuk mund ti marrësh. Për sa kohe nuk ka asnjë rregull që nuk mund ti marrësh, por ka një rregull që mund ti marrësh që është shkruar në Kushtetutë, besoj që mund ti marr dhe është përgjigjësia ime nëse i keqpërdor. Kërkesa që kam bërë me shkrim është në kuadër të transparencës dhe unë mendoj se në asnjë çast Këshilli nuk është i ndaluar të diskutojë transparencën. Këshilli në çdo moment mund ta diskutojë transparencën nëse një gjë nuk ecën. Sepse është diskutuar edhe që nuk është ky momenti që u ngrit ky problem. Unë mendon që çështjet e transparencës janë të vetmet që mund të diskutohen në çdo moment. Megjithatë ky është qëndrimi juaj dhe sigurisht e drejta juaj ashtu siç dhe unë kam të drejtat e mia, ju keni të drejtën tuaj për ta lexuar apo për të mos e lexuar ligjin. Por unë nuk kam asnjë qëllim për ti bërë gjyq asnjë njeriu, dhe as për të arritur ndonjë konkluzion dhe as të pranoj konkluzionin e ndokujt që po i bëj gjyqin x-it apo y-it. Këtë gjë nuk e pranoj.

Kryetari i Këshillit shtron pyetjen dhe anëtarët dakordësohen që të votojnë përfundimisht qëndrimin e tyre për të hyrë në një procedurë diskutimi dhe për të ndryshuar ose jo rregullat ekzistuese.

Ardian Dvorani shpreh qëndrimin dhe voton që të mos ndryshohen rregullat në këtë moment.

Vitore Tusha shpreh qëndrimin dhe voton për të mos rihapur përsëri këtë lloj diskutimi për ndryshime, përfshi këtu nëse jemi me shumice apo pakicë.

Arta Marku shpreh qëndrimin dhe voton nuk jam që të merret në konsideratë ky lloj propozimi.

Fatri Islamaj shpreh qëndrimin dhe voton se në mënyrën se si ushtrohet pyetja unë nuk gjej asnjë pengesë ligjore që rregullat të mos diskutohen, mos të përmirësohen, mos të amendohen sipas nevojave.

Margarita Buhali shpreh qëndrimin dhe voton se nuk shikoj asnjë pengesë për tu diskutuar nëse do i shërbenin për mirë zbatimit të ligjit dhe për më tepër unitetit të të treja akteve që ne kemi nxjerrë, uniformitetit të tyre. Në çdo moment mund të diskutohen.

Fatjona Memçaj shpreh qëndrimin dhe voton se jam për mosndryshimin e rregullave.

Eriol Roshi shpreh qëndrimin dhe voton se mund të diskutohet për ndryshimin e rregullave, por jam kundër ndryshimit të këtij rregulli.

Kryetari i Këshillit fton zotin Bledar Dervishaj të shprehet sipas kërkesës së tij lidhur me rregullat që zbatohen për lejimin apo ndalimin e kandidatimit të një kategorie kandidatësh.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtrohet se çështja që shtroj është pak më ndryshe dhe është e rëndësishme së veçantë, mendoj unë. Para se gjithash do të kthehem pak në histori sepse për vetë nga natyra që ka Institucioni i Presidentit i Republikës ose prezenca jonë në këtë mbledhje të Këshillit. Përveçse ndjekim veprimtarinë e Këshillit dhe ecurinë e punës së tij, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe kreu i shtetit ndjekim edhe veprimtarinë e organeve të tjera dhe kryesisht edhe të atyre që janë krijuar në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë, që nga momenti i konstituimit, mënyrën se si po ecin, si edhe implementimin e atyre rregullave të diktuar nga Kushtetuta dhe ligji. Në këtë kontekst, për gjatë këtyre muajve pas krijimit të KLGJ dhe KLP, përpos rregullave të miratuara nga Këshilli, unë e citova pak dhe në mbledhjen e kaluar, vlerësoj me vend ti vija Këshillit në vëmendje për ta diskutuar se midis tre organeve më të rëndësishme KLP, KLGJ dhe KED ka një dallim të vlerësimit sa i takon gjendjes procedurale të një subjekti që përfshihet në procesin e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë për Prokuror të Përgjithshëm, për prokuror në Prokurorinë SPAK, për gjyqtarë në Gjykatën e posaçme apo gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Bëra një parantezë herën e kaluar që nëse i shikojmë aktet nënligjore të këtyre tre organeve, Këshilli i Lartë Prokurorisë, në rregulloren për kandidatimet për Prokuror të Përgjithshëm ka përcaktuar se subjektet që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar do të vazhdojnë garën pasi të kenë një vendim të formës së prerë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pra duke e konsideruar procesin e rivlerësimit të përmbyllur me vendim përfundimtar për Prokuror të Përgjithshëm dhe për prokuror në Prokurorinë e Posaçme. I njëjti rregull është vendosur edhe nga KLGJ për anëtarët që do të kandidojnë në

Gjykatën e Posaçme, ndërkohe që KLGJ, për kandidatët që konkurrojnë për rritje në detyrë ndoshta edhe deri në Gjykatën e Lartë, nëse jam korrekt, kalojnë në një rregullim tjetër.

Pra ne diktuam që tre organet kane të përcaktuar kritere të ndryshme. Ndërsa KED-ja, për anëtarët kandidat në Gjykatën Kushtetuese dhe ILD, ka vendosur që një vendim negativ ndalimi ose shkarkimi nga KPK-ja të bën të pamundur të kandidosh, sikundër një vendim pozitiv i KPK vijon procesin konkurrimit. Ky është rregulli që është vendosur me vendimin nr.4. Në parim, rreth këtij diskutimi unë kam shtruar se a mos është vendi që Këshilli ta diskutojë edhe njëherë nisur nga kërkesat e Kushtetutës, ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ligjit për procesin e rivlerësimit kalimtarë, për të mbajtur një qëndrim nëse do të ndryshojë këtë rregull që ka miratuar apo do vazhdojë me të njëjtin rregull. Unë iu riktheva dispozitave kushtetuese disa herë, edhe atyre referencave ligjore që janë përmendur në disa vendime ndalimi të përgatitura nga Këshilli dhe psh. me rezulton tek ligji për “Gjykatën Kushtetuese” janë dy referenca që duhen të vlerësohen. Nga këshilli është përmendur vetëm shkronja “d” e nenit 7/a të Ligjit nr.8577 dhe shkronja “dh” që parashikojnë dy nga kushtet që duhet të plotësojnë një kandidat: gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetas shqiptar që përmbush këto kushte. D-ja është të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë mase disiplinore në fuqi dhe “dh” që të ketë përfunduar me sukses procesin dhe kontrollin e verifikimit të pasurisë personale dhe të familjareve të tij sipas ligjit. Ndërkohë që nëse i nënshtrohet, shikojmë pas ligjin nr.84/2016 për rivlerësimin kalimtar, neni 4 pika 2, Komisioni dhe Kolegji janë institucione që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve rivlerësimit. Marrë në tërësinë e tyre, gjithmonë e kërkuar në parim nga unë këtu, është a është momenti që Këshilli ta ridiskutojë serish këtë çështje? Sepse mund të ndodhi, është diskutuar në këtë tryezë edhe në mars që një kandidat i suksesshëm mundet të përfshihet në listën e tre anëtareve që i propozohen Kuvendit dhe Presidentit për tu zgjedhur, mund edhe të zgjidhet dhe më pas mund të shkarkohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Në këtë moment a cenohet besimi i publikut nga ky produkti i veprimtarisë së institucioneve të reja? Sepse po ti referohem nenit 179/b të Kushtetutës pikës 1e 2, dy qëllime ka sistemi i rivlerësimit, të rikthehet besimi i publikut dhe të kthehet duke respektuar një standard të një procesi të rregull në respektimin të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst për raste hipotetike që mund të ndodhin dhe siç ka ndodhur me anëtarët e KLP-sëe, mund të ndodhi, shtroj për diskutim në këshill një qëndrim parimor në lidhje me aktin nënligjor vendimin nr. 4 date 11.03.2019. Gjithmonë më mirëkuptoni është kërkesë parimore.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehin qëndrimin se është e vërtetë që ka disa qasje të ndryshme mes tre organeve dhe secili bën vete interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjit

të lidhur me veprimtarinë e tij. Në ndryshim nga KLP dhe KLGJ , KED ka afate shumë të shkurtra për të aplikuar p.sh sipas ligjit për Gjykatën Kushtetuese kombinuar me ato të ligjit të organeve të qeverisjes së drejtësisë. Vendimet e KPK për shkarkim, vetvetiu për shkak të Kushtetutës dhe ligjit, sjellin pezullimin nga detyra funksionale dhe ligji i ka njohur magjistratit vetëm të drejtën të marrë një pjesë të pagës. Rastet e shkarkimit të rivlerësimit kalimtar janë pak a shume ngjashme me atë kur kandidati mund të merret në përgjegjësi penale, rast në të cilën nuk ka se si KED të pezullojë procesin deri sa të ketë një vendim përfundimtar fajësia apo pafajësie. Ndërsa në rastin e kandidateve të konfirmuar nuk mund të paragjykohet kandidati, i cili vijon detyrën e tij, lidhur me atë se çfarë mund të ndodhë në KPA. Këshilli e shqyrton kandidaturën me gjendjen e fakteve ne momentin e zhvillimit të procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave. dhe jo me gjendjen që ndodhin mbas saj. Në situatën ku jemi ajo që është më e rëndësishme është krijimi i institucioneve, ndërkohë edhe afatet ligjore i kemi shumë të shkurtra . Në këtë mënyrë është operuar edhe për zgjedhjen e anëtareve të KLGJ dhe KLP. Por sikurse KED edhe institucionet e tjera duhet të punojnë paralelisht me të njëjtën shpejtësi dhe seriozitet.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtron se doja vetëm të beja një shtesë duke marrë shkas nga ajo që tha znj. Buhali. Imagjinoj organet e emërtesës, i kanë shpallur vakancat me datë 07.02.2018. Unë them me bindje se i kam punuar me dorën time të gjithë atë praktikë që i është përgjigjur vakancave në Gjykatën Kushtetuese për tu shpallur dhe për te kërkuar mbledhjen e Këshillit dhe institucioni më i interesuar ka qenë dhe është Presidenti i Republikës. Është i pari që ka kërkuar mbledhjen e Këshillit, jo të këtij se u vetëmblohdh, por të Këshillit të kaluar. Sapo u shpall vakanca e parakohshme shpalli të dytën, i administroi kandidaturat, i solli dhe kanë kaluar 16 muaj. Kjo është një gjendje shqetësuese që në 16 muaj këta aplikantë kanë qenë, procesi veting ende ska përfunduar në shkallë të parë dhe tashti i vjen një kandidaturë që i uroj me të mirat me vendimi jopërfundimtar. Uroj nuk ndodh që shkarkohet. Në këtë logjike e kam gjithmonë. Më fal Avokati i Popullit, doja ta citoja sepse e kemi ndjekur dhe nuk kemi munguar në një mbledhje të Këshillit, më duket 22 mbledhje, me qëllimin e mirë që Gjykata Kushtetuese të jetë sa me shpejt funksionale.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se unë besoj që Gjykata Kushtetues nuk është dhe s'mund të jetë emergjence kombëtare vetëm për KED, por ajo duhet të jetë emergjencë kombëtare në radhë të parë për organet e rivlerësimit kalimtar sepse ata kanë pasur kohën më të gjatë në dispozicion për ta bërë këtë pune. Qartësisht mendoj se nuk ka asnjë lloj justifikimi që, siç punoi ky Këshill nga janari deri sot për të evaduar një masë kaq të madhe pune dhe siç po punon dhe bën gjithë këto mbledhje, mund të punojnë edhe organet e tjera të cilat kanë më tepër

stafe, janë të ideuara, të menduara dhe të organizuara pikërisht për të bërë këtë gjë. Nuk e gjej në asnjë rast të justifikuar pretendimin se vihemi në këtë pozite se duhet të jemi ne i vetmi organ që duhet ta çojmë reformën përpara. Gjykoj se reforma është produkt i shumë organeve dhe secili prej tyre duhet të bëjë punën e vet brenda parashikimeve përkatëse. Nuk shoh asnjë arsye që ne nuk kemi asnjë gjyqtar sot që flasim që ta ketë kaluar tërësisht procesin dhe nuk e dimë, shpresoj ta kalojnë këta që janë procesin. Por diskutimi që unë kam është që mbas një viti kaq muaj, pra 16 muaj, procesi në shkallë të parë do të duhet të kishte përfunduar, shtuar këtu detyrimin kushtetues që kanë organet emërtesës që të zgjedhin dhe gjyqtarë dhe jo gjyqtarë, i bie që domosdoshmërisht nga organet e emërtesës për këto kandidatë do të këtë gjyqtare sepse organet e emërtesës kanë për detyrë që të balancojnë numrin me gjyqtarë e jogjyqtarë. Do të këtë patjetër gjyqtare të cilët ata do të duhet të zgjedhin me domosdoshmëri për shkak e balancës që do të duhet të ruajnë në Gjykatën Kushtetuese. Në kuptim të ligjit duhet të jenë edhe gjyqtarë. Në këto kushte as pjesa me e madhe e tyre, nëse do këtë ankim, sepse nuk e dimë, do jetë në një mënyrë ose tjetër me një deklaram publik se nuk duhet të vazhdojmë detyrën. të argumentuar. Neve këtu në këtë Këshill kemi konsideruar informacion të sjellë nga dikush për probleme që lidhen me vendimmarrjen. Si do të duket para publikut fakti që ka një ankim nga komisioneri publik për këta persona, i argumentuar, i trajtuar që ato s' duhet të vazhdojnë detyrën dhe kërkon shkarkimin tyre nga detyra dhe Këshilli ka për ta propozuar dhe për ta promovuar? Kështu që mendoj dhe bashkohem me mendimin të gjithë anëtareve që qartësisht do ishte shume mirë për këshillin që të ishte mbaruar procesi në të dyja shkallët. Jam duke diskutuar faktin, a do përbëje burim prove ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik për ne për ta rankuar më poshtë? Sepse ne kemi thënë flisni njerëz çfarë mendimi keni, çfarë përshtypjesh keni, na i sillni ne ti trajtojmë dhe ti vlerësojmë.

Këshilli mundet të gjendet në një ngërç vendimmarrjeje në një moment tjetër, duke përjashtuar dhe duke mos dashur fare qasjen e idesë që të këtë gjyqtarë kandidatë të propozuar nga Këshilli apo të rankuar në treshen parë nga ana e Këshillit dhe të përzgjedhur edhe për shkak të detyrimit se duhet me përzgjedh ndonjë gjyqtar gjithsesi nga ana e organit të emërtesës, të cilët mundet të mos e kalojnë. Ajo do ishte vërtet një veprim me ulje të jashtëzakonshme besoj të besimit të publikut ndaj organeve të reja të drejtësisë apo të këtij sistemi qeverisje dhe për faktin se ka një sfidë jo të vogël për ata persona të cilët nuk kalojnë vetingun, aq shumë sa fjala veting është bërë sot dëshira e çdo personi për tju nënshtruar dikush tjetër në çdo fushë, pra është Shpata e Demokleut për çdo individ. Kështu që unë vërtet do të mundohesha që të kishim ndonjë mundësi, nuk e di se si mund të zgjidhej, po të kishim ndonjë mundësi që vendimmarrjet në lidhje me këtë çështje të ishte për persona të cilët e kanë përfunduar procesin

e vetingut sepse e thotë vetë ligjit, të kenë kaluar procesin e vetingut. Të paktën për Gjykatën Kushtetuese ka një përcaktim të qartë që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese janë persona të cilët kanë kaluar me sukses procesin e vetingut dhe procesi i vetingut nuk është një shkallë qoftë në të mirë qoftë në të keq. Sigurisht që nuk kam asnjë lloj dyshimi që ju z kryetar dhe të gjithë relatorët kanë bërë kërkesa me shkrim pranë KPA për ta përshpejtuar procesin, edhe pranë KPK për ta bërë një gjë të tillë, por ne nuk mundet që një proces, i cili, në asnjë dispozitë, në asnjë afat, nuk ka qenë në rregull me parashikimet kushtetuese, mendoj që duhet me qenë të kujdesshëm edhe në kuadër të cilësisë. Ata mbarojnë me shpejtësi, ti kalojnë edhe këta sepse i bie që na e lënë topin ne. Ata thonë nuk kemi kohë ne dhe merrni ju vendime që mund të jenë të diskutueshëm. Nëse ka ankim si do ta zgjidhnim këtë sepse është problem shumë i madh dhe kemi shumë pak gjyqtarë. Kjo është çështja. Pra qartësisht Këshilli është nën detyrimin kushtetues që të rankojë edhe gjyqtarët.

Siç u mblodh ky Këshill me prioritet, bëri rregullore dhe fitoi kohë, sigurisht me ndihmesën e Euralius-it, e që akoma nuk i ka bërë KLGJ-ja, mund ta kishte shqetësim edhe KPA apo KPK këtë gjë dhe që e kanë detyrë kushtetuese për ta bërë brenda fateve që u ka dhënë ligji. Ata nuk i bënë brenda afateve që u ka dhënë ligji por e vendosin këtë Këshill nën presion ndoshta te një pune më e mirë. Nuk e kam nga mënyra se si parlamenti kohët fundit bën rezoluta dhe kërkon që të tjetër, të gjithë ne, të bëjmë punët e veta. Unë në organin tim në punën e time kushtetuese, KED-ja sigurisht, bëjmë punë më te mirë informues për publikun për kompetencat e veta. Ndoshta edhe ju mund të konsideroni idenë që Këshilli mund ta trajtonte këtë si problem dhe ta adresonte që qytetarët ta kuptojmë që nuk varet nga Këshilli çdo gjë. Kjo gjë varet në më të mirën nga organet e tjera të cilët duhet të bëjnë edhe ata punën e tyre. Mund të jeni më të qartë. Çdo organ kushtetues ka thënë Kuvendi, përfshirë edhe mua, të bëjë punën vet për edukimin e publikut për atë kompetencë që ka. Mua më ka thënë pse të sjellin ty më shumë kërkesa, edhe kur janë jashtë juridiksionit është faji jot dhe duhet ta besh ti. E kam në rezolutë, pse në Avokatin e Popullit njerëzit çojnë kërkesa që nuk janë brenda kompetencës së vet? Do të thotë që ti nuk ke bërë mirë punën tënde informuese. Prandaj të shtojë Avokati i Popullit rolin e vet për të informuar publikun. Kështu e shikojnë të tjerët. E them këtë jo se kjo nuk ka rendësi por dua të them që qasja e shumë organeve, aq më tepër qasja për efekt të reformës në drejtësi do jetë një qasje që mundet ta vërë Këshillin në vështirësi, në gjykimin tim. Prandaj në këtë kuadër e them çështjen e informimit sepse është qartë që ka ndjeshmëri të tilla nga shumë subjekte. Është e vërtet që ju z. Kryetar keni referuar në një konferencë, kemi qenë dhe bashkë, keni thënë që e nëse organet tjera bëjnë punën tyre Këshilli është i gatshëm të shkojë me kandidaturat edhe brenda majit. Por diskutimi që unë kam është parimor. Besimi i

publikut tek ky organ nëse personat e propozuar nga ky Këshill fatkeqësisht do të humbasin, nuk do ta kalojnë.

Në këtë këndvështrim kemi qënë bashkë në këtë diskutim dhe kam thënë që në shkurt se sikur ky Këshill të punojë përditë, në rastin më të mirë mund të çojë kandidatura brenda qershorit. Këtë e kam thënë në shkurt kur të gjithë prisnin që ju ti mbaronit këto gjera brenda një afati dy javor. Në fakt ka pasur deklarime publike që për dy javë KED do të çojë kandidaturat. Ka qënë çështje dëshirash që thonin nuk është problem se për dy jave do të çojë emërtesat dhe në atë kohë kam thënë sikur të punojë përditë Këshilli deri në fund të qershorit, duke mos marre parasysh edhe diskutimin organeve të tjera. Por situata duhet trajtuar me shumë seriozitet sepse ka të bëjë me besimin tek reforma në drejtësi, pa diskutim ka të bëjë me rezultatin e kësaj pune të jashtëzakonshme që secili prej anëtareve është duke bërë dhe që i bie akoma të vazhdojë me procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të të gjithë kandidateve. Duhet që të trajtojmë dhe një problem tjetër që unë shikoj realisht dhe që është fakti që Këshilli do të ketë në konsideratë gjithmonë e më pak kandidatë. Kjo besoj se është një këmbanë alarmi që ndoshta këshilli duhet ta... Sepse përjashtimi, dmth mundësia e përzgjedhjes ka ngelur shumë e vogël.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtron se kjo ngjalli goxha horizont dhe tashmë po mendoja si organ emërtese kur të vijë kandidatët. Dhe nga diskutimi i Erindës. Imagjinoni Kuvendin që kërkon që një anëtare të gjykatës ta zgjedhi me 84 vota. Edhe Presidentin i cili është në një zgjedhje individuale për të bërë zgjedhje nga tre të parët, ku publikisht do të konkurronin dy vokacione. Një pozitiv i bërë nga KED që do të shoqërojë kandidaturat bashkë me një raport përmbledhës për kandidatet dhe një negativ i shpallur publikisht nga Komisioneri Publik dhe ONM-ja. Në një farë mënyrë i takon dy organeve të emërtesës, deputeteve të Kuvendit mos të ngrinin kartonin dhe Presidentit se ky paraqet problematikë. Në këtë moment ajo që vihet në diskutim është cilësia e punës së Këshillit. Organi i emërtesës të zgjedhja do ta këtë problematikën. Këshilli zgjedh, ndërkombëtarët dhe komisioneri që mbron interesat e publikut atë që dëshiron të jetë në sistem. Në të dyja anët shumë delikate. Prandaj e kam thënë shpesh që në mars që një ushtrim i vështirë për Këshillin është pikërisht kjo vendimmarrje e këtij akti nënligjor, ma kujtoi avokatja në fjalën e vet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, duke falënderuar përfaqësuesit e Euralius për praninë dhe kontributin në diskutimet e çështjeve të deritanishme të rendit të ditës, njofton kalimin në shqyrtimin e rasteve të programuara të gjetjeve të procedurat e verifikimit të disa kandidatëve.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Luan Dervishi.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidatin Luan Dervishi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur me datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se unë mendoj se do të ishte me vend që KPA-ja të kishte pasur në konsideratë pezullimin tonë për vendimmarrje në lidhje me personat të cilët e kanë përfunduar procesin e verifikimit në këtë shkallë. Ky proces është në 2 shkallë. Kështu që gjykoj që do të duhet që edhe organet e tjera të kenë vëmendjen e tyre për të ndihmuar në procesin e krijimit dhe ngritjes së Gjykatës Kushtetuese dhe për të mos e cënuar vendimmarrjen e këtij Këshilli. Por, nga ana tjetër, edhe për të mos cënuar të drejtat e individëve të cilët nuk kanë një vendim të formës së prerë për tu përjashtuar nga sistemi gjyqësor. Nuk është e ndaluar në gjykimin tim, kërkesa ose e drejta e këtij kandidati për tu zgjedhur vetëm për shkak të vendimit të shkallës së parë sepse në fakt unë ndaj një mendim ndryshe nga mendimi që ndau më parë përfaqësuesi i Presidentit. Kjo nuk është ngritje në detyrë brenda sistemit. Është një kërkesë me vete dhe Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e sistemit të karrierës brenda sistemit gjyqësor. Unë kam mendimin tim, më fal në qoftë se nuk e paskam kuptuar. Kështu që gjykoj që nëse kandidati do të dilte gjyqfitues në fazë të dytë sigurisht që atij do ti ishte cënuar kjo e drejtë që ai të ishte pjesë e kandidimit. Por sigurisht ka dhe mundësi të tjera dhe ai mund ta provoj në vakanca e tjera veten. Përsa i përket gjetjes konkrete dhe propozimit të bërë nga ana e relatorit mendoj se ai është në përputhje me rregulloren e miratuar nga ky Këshill dhe nuk shikoj për sa i përket gjendjes aktuale të akteve, pra të rregullores siç është, se ka ndonjë cënim të së drejtës së tij. Por në kuadër të një interpretimi më të gjerë kushtetues mund të kishte një cënim të të drejtës të këtij personi për të vazhduar procedurën dhe për të pasur të drejtë për tu zgjedhur duke qenë se nuk ka një vendim të formës së prerë për ta përjashtuar atë nga sistemi.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Rovena Gashi.

Eriol Roshi, parashtron relatimin për kandidaten Rovena Gashi për vendin vakant plotësues për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se në rastin konkret vendimi është përfundimtar. Kandidatja i ka kaluar të dyja fazat e shqyrtimit në procedurën e rivlerësimit kalimtar, pavarësisht faktit publik se ka një çështje e cila po shqyrtohet nga Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut. Për këtë mendoj se ligji në rastin konkret qartësisht e ndalon kandidimin e saj dhe sigurisht që reparacioni do të ishte një mënyrë që mund ta gjente më tej, nëse do të dilte gjyqfituese në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Por nuk shikoj për momentin ndonjë problem në lidhje me këtë relacion.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Rovena Gashi.

Arta Marku, parashtrohet relativisht për kandidaten Rovena Gashi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur me datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se pavarësisht gjetjeve të relacionit, që janë të sakta dhe konkrete, mendoj se ndoshta në këtë rast për shkak të faktit se znj. Gashi ka pasur një konflikt publik me zonjën Marku, unë do të mendoja që ndoshta do të ishte rasti që mund të ishte konsideruar pjesëmarrja e saj në lidhje me këtë rast për të qenë relatore. Nuk kam asnjë çështje në lidhje me vendimmarrjen, por në sytë e publikut mundet të konsiderohet një situatë konflikti interesi dhe unë nuk do të doja që kandidatët e përjashtuar ta përdornin për të cenuar në çfarëdo mënyre reputacionin e këtij Këshilli. Nuk kam asnjë problem në lidhje me vendimmarrjen e cila do të ishte e njëjtë pavarësisht emrit të anëtarit relator.

Arta Marku merr fjalën dhe shpjegohet se në fakt nuk kam pasur asnjë lloj konflikti personal me kandidaten. Konflikti ka qenë institucional. Ka ndjekur gjithë rrugën procedurale. Për më tepër në momentin që jam caktuar unë relatore kandidatja ka qenë e shkarkuar në shkallë të parë nga KPK kështu që nuk kam bërë asnjë lloj hetimi apo verifikimi veçse një konstatim të fakteve që paraprakisht është bërë dhe nga kolegu tjetër. Kështu që unë nuk quaj që jam në kushtet e konfliktit të interesit pasi do të kisha dhënë dorëheqjen me kohë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Margarita Buhali të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Elira Kokona.

Margarita Buhali parashtron relatimin për kandidaten Elira Kokona për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se procedura duket se është e realizuar në përputhje me parashikimet. Vullneti i kandidates është i qartë për të paraqitur dorëheqjen e saj me efekt të menjëhershëm si dhe anulimin e autorizimeve të firmosura prej saj për këtë procedurë. Kështu që mendoj se Këshilli duhet ta ndërpresë procedurën përkatëse të verifikimit të mëtejshëm për kandidimin e saj duke qenë se ajo nuk ka më vullnet për të qënë kandidatë për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Kestrin Katro.

Fatri Islamaj parashtron relatimin për kandidaten Kestrin Katro për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca, sipas procedurës për dhënien e mendimit nga Avokati i Popullit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kësaj kandidature merr fjalën dhe shprehet se vullneti rezulton që të jetë i qartë dhe mendoj se jemi përpara kushteve të ndërprerjes së procedurës së verifikimit.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Prel Martini.

Vitore Tusha parashtron relatimin për kandidatin PreL Martini për vendin vakant, vakancë e parakohshme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 26.11.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Erinda Ballanca shtron pyetjen nëse komunikimi i vetëm që Këshilli ka bërë është nëpërmjet kontaktit të numrit telefonik. Ndoshta e kam unë gabim, ka pasur një sms dhe një telefonatë. Nuk ka letër postë. I keni dërguar letër në adresën e postës që personi ka lënë në adresën postare?

Vitore Tusha shpjegon se janë përdorur ato të dhëna që ai ka lënë pranë Këshillit.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se është ndoshta është për tu aplikuar gjithmonë rregull i këtij Këshilli se kësaj vakancë i ka përfunduar mandati që do të ushtrohej në rast se do të zgjidhej. Ndaj, Këshilli kryesisht i bën të ditur organit të emërtesës deri në fund të majit jo vetëm për këtë kandidatë por edhe për z.,Sinan Tafaj që kandidon për këtë vakancë sepse kohëzgjatja e ushtrimit të mandatit ka përfunduar më 24 maj. Për të mos kaluar tek vendimmarrja e ndalimit mund të bëhej mbyllje të procedimit sepse ka mbaruar afati.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani sjell në vëmendje kanë mbetur për shqyrtim edhe dy pikat e tjera të rendit të ditës. Është në fakt një ankim administrativ i kandidatit Vasil Bendo, i cili, të paktën me aq sa jemi njohur edhe nga pretendimet që ka ngritur edhe në Gjykatën Administrative të Apelit edhe këtu parashtrohet ekzaktësisht të njëjtat pretendime. Ka sjellë një lloj ankimi administrativ tek ne që ne të marrim vendim për të revokuar vendimin tonë të mëparshëm dhe të disponojmë rivendosjen në afat për paraqitjen e deklaratës së pasurisë. Në gjykatën administrative është vendosur rrëzimi i kërkesës së tij për shfuqizimin e vendimit të KED dhe kanë çuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative të shprehet lidhur me kërkimin tjetër për rivendosjen në afat.

Erinda Ballanca shtron pyetjen për këshilltarët që kanë qenë përfaqësues në gjyq nëse gjykata në vendimmarrje kishte thënë që nuk keni bërë ankim administrativ apo jo? Aty kisha dërguar një njeri ngaqë vetë isha në Këshill dhe mu referua që pikërisht Gjykata kishte thënë që do të duhej të ishte bërë një herë ankim administrativ, të shteronte rrugën administrative.

Anëtarët e Këshillit sqarojnë se vendimi i aryetuar i gjykatës nuk është zbardhur por nuk ka rezultuar në gjykim diçka e tillë, përndryshe gjykata do të dispononte nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe jo rrëzim padie etj. Prandaj duhet të pritet zbardhja e vendimit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani sjell në vëmendje çështjen e fundit. Është rasti i gabimit material në vendimin e KED për përfundimin e procedurave për kandidaten Lefterije Lleshi Luzi.

Margarita Buhali në cilësinë erelatores së asaj vakance shpjegon se në mënyrë të përmbledhur kandidatja Lefterije Lleshi i ka bërë një kërkesë KED për korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin e marrë për të për përfundimin e procedurës së verifikimit për shkak të tërheqjes nga kandidimi. Pretendon se është bërë gabim në pikat 8 dhe 23 të vendimit ku është pasqyruar sikur ajo është paraqitur në datën 08.04.2019 për tu pajisur me formularët dhe autorizimet dhe pretendon që nuk është paraqitur por ka bërë vetëm një dërgesë të emailit për tërheqjen e saj nga kandidimi. Pretendon që edhe në rast se mund të jetë paraqitur një kërkesë e tillë për tu pajisur me dokumentacion nuk ka qenë bërë prej saj pra mund të vihet në dyshim fallsiteti i këtyre të dhënave. Nga verifikimet që u kryen rezultoi i drejtë shqetësimi dhe

kërkesa që ngre kandidatja. Kanë ndodhur gabime materiale ashtu siç i pretendon ajo në pikat 8 dhe 23, ndoshta edhe për shkak të mbivendosjes gjatë punës që është bërë mbi vendime të tjera. Kështu që për mendimin tim, me të drejtë duhet të vendoset ndreqja e gabimeve materiale të vendimit të dhënë për të, konkretisht duke u hequr pika 8 edhe pika 23, në pjesën ku është pasqyruar që ajo është paraqitur në datën 08.04.2019. Të vendimi dhe të urdhërohet bashkimi i këtij vendimi të ndrequr me vendimin objekt ndreqje që të jenë pjesë integrale të dyja bashkë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 21.37

Sekretare

Dorina Dulaj

Redjona Myrtja

Ermelinda Kadiu

Kryetari

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.